



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 63/09

Prishtinë, më 11.11.2009, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Gani Koci, Kosara Nikolić, Myrvete Pantina, Haki Shatri, Armend Zemaj, Müfera Şinik dhe Xhevdet Neziraj.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Suzana Novobërdaliu, Hajdin Abazi dhe Besa Gaxherri.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Natasha Prica-Tisma dhe Dashurie Canolli.**

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: **Ahmet Shala – Ministër i MEF-it, Arsim Bajrami – Ministër i MAD-së, Naile Krasniqi nga KPM-ja, pjesëmarrës nga GTZ, monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE, USAID, KDI.**

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 21.10.2009;**
- 3. Dhënia e sqarimeve nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Administratës Publike lidhur me moszbatimin e rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur kërkesën për rishikimin funksional dhe nivelizimin e pagave brenda Komisionit të Pavarur për Media**
Të ftuar : z. Ahmet Shala , Ministër i MEF-it dhe z. Arsim Bajrami, Ministër i MAD-së;
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.03/1192/L-104/1 për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe siguria nukleare, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente**
I ftuar: Naim Maloku, kryesues grupit punues të Komisionit;
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit kundër korrupsionit me raportin e Komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;**

6. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve për Projektligjin nr. 03/L-170 për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale;
7. Shqyrtimi i Projektligjit për Financim e Subjekteve Politike;
8. Shqyrtimi i Projektligjit për borxhet publike;
9. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010;
10. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi, konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara dt. 21.10.2009

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e kaluar dt. 21.10.2009, miratohet pa vërejtje.

3. Dhënia e sqarimeve nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Administratës Publike lidhur me moszbatimin e rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur kërkesën për rishikimin funksional dhe nivelizimin e pagave brenda Komisionit të Pavarur për Media

Ahmet Shala, Ministër i MEF-it, lexoi kërkesën e KPM-së dhe rekomandimet e Komisionit dhe për përkrahjen e kësaj kërkesë. Theksoi se pasi që ajo nuk përmban implikime buxhetore shtesë, për MEF-in është e pranueshme të përkrahet përkohësisht.

Kryesuesi, theksoi se kërkesën e KPM-së e kemi pasur të kompletuar, duke përfshirë edhe ndryshimin e koeficienteve dhe me këto ndryshime është miratuar nga komisioni. Pasi që nuk kemi një rregullativë të përgjithshme për pagesat e agjencioneve të pavarura, jemi obliguar si komision të rekomandojmë për një zgjidhje të këtillë. Kërkesa ka të bëjë me një rishikim funksional dhe nivelizim të pagave cili nuk ndryshon kufijtë buxhetor të këtij agjencioni.

Arsim Bajrami, Ministër i MAP-së, jemi të interesuar të gjejmë një zgjidhje të përkohshme, deri sa të miratohet ligji për paga që pritet të zgjidh këto probleme. Marrim kërkesa për lëvizje e koeficinetëve nga institucione dhe agjencione të ndryshme. Në këtë drejtim kemi dy situata, njëra kur agjencionet i lëvizin vetë këto koeficiente dhe i sjellin për miratim në ministri dhe situata e dytë vetëm kërkojnë ngritje të koeficienteve dhe ne si DASH duhet të vendosim për këtë. Jemi të gatshëm të respektojmë rekomandimet e komisionit tuaj, për një zgjidhje të përkohshme të kësaj kërkesë, me shpresë që këto probleme të zgjidhen me Ligjin për paga.

Kryesuesi, përkujtojë letrën e Ministrin Shala që rregullatorët dhe agjencionet e pavarura të kenë një trajtim të veçantë në buxhetin e tyre. Gjithashtu përmendi edhe Raportin e ICO që buxhetet e rregullatorëve të trajtohen në mënyrë të veçantë. Si rezultat i mungesës së rregullatives ligjore, Komisioni është obliguar të nxjerr rekomandimet e veta, të cilat në disa raste nuk janë respektuar nga ministria përkatëse.

Naile Krasniqi, kërkesa jonë është më specifike. Në planin e Veprimit për Partneritet Evropian për vitin 2009 është përcaktuar që KPM-së t'iu ndahen mjete të mjaftueshme buxhetore. Kërkesa si e tillë nuk përmban implikime buxhetore, është brenda buxhetit të miratuar.

Kryesuesi, për disa kërkesa buxhetin e përcakton ligji, te disa agjencione kemi probleme në përcaktimin e buxhetit të tyre. Komisioni interesohet për ato agjencione që i përgjigjen Kuvendit, që

përcakton buxhetin e tyre dhe kontrollon ato. Prandaj rekomandimet e Komisionit dhe vendimet e Kuvendit duhet të respektohen deri në rregullimin e kësaj çështje me ligj.

Arsim Bajrami, Ministër i MAP-së, pasi kemi të bëjmë me një kërkesë specifike, u pajtua për një zgjidhje të përkohshme të saj, deri në miratimin e Ligjit për pagat.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Përkrahet kërkesa ref.0911/2026/EXD/nsk e Komisionit të Pavarur për Media dhe Transmetim për implementimin e procesit të shqyrtimit funksional dhe nivelizimin e pagave të stafit përbrenda Komisionit të Pavarur për media dhe transmetim, ngase e njëjta nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
- II. Ngarkohen Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe Ministria e Administratës Publike që të veprojnë sipas rekomandimeve të Komisionit për Buxhet dhe Financa nr. 03/2176/Do-1349, të datës 15.05.2009 dhe nr. 03/2384/Do-1491 të datës 18.06.2009, deri në nxjerrje të Ligjit për pagat e institucioneve të pavarura.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për Financim e Subjekteve Politike

Kryesuesi, propozoi që të krijohet grupi punues për shqyrtimin dhe amendamentimin e këtij projektligji, i cili tashmë është miratuar në parim në Kuvend. Do të ishte mirë të ishin pjesë e këtij grupi, të anëtarët e gjitha partive politike.

Haki Shatri, u pajtua që të jetë pjesë e grupit punues, por se kërkoi një sqarim se a do të duhej që ky projektligj të miratohet paralelisht me miratimin e buxhetit apo veçmas?

Pas propozimeve u krijua grupi punues në këtë përbërje:

1. Armend Zemaj (kryesues)
2. Gani Koci
3. Kosara Nikolić
4. Haki Shatri.

4. Të ndryshme

Kryesuesi, njoftoi se më dt. 17.11.2009 do të jetë një seminar i organizuar nga GTZ për anëtarët e komisionit, në të cilin do të diskutohet për çështjen e buxhetit, të cilin do ta kemi edhe në diskutim.

Në mungesë të kuorumit, pikat tjera të parapara në rend dite u shtyhen në mbledhjen e radhës së komisionit.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Gani KOCI